



Zgjedhjet - Izbori - Elections

Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

UNË VOTOJ VET



Zgjedhjet Lokale – 3 Nëntor 2013

Zgjedhjet për Kryetarë Komunash dhe Asamblenë Komunale mbahen me 3 nëntor në të gjitha Komunitat e Kosovës. Si votues me nevoja të veçanta, ju keni të drejtë të votoni në mënyrë të lirë dhe të pavarur.

Votues me nevoja të veçanta konsiderohen:

- **votuesit e ngujuar në shtëpi:** të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin për shkak të paaftësisë fizike, shëndetësore ose çfarëdo paftësie tjetër;

- **votuesit me lëvizje të kufizuar:** të cilët janë në hospitalizim, njerëzit e moshuar, personat me aftësi të zvogëluar mentale në institucionet e kujdesit shëndetësor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit;

- **votuesit në rrethana të veçanta:** të cilët jetojnë në bashkësitë, të cilët për shkak të zhvendosjes nga vendi afër vendvotimit të tyre të rregullt ose për shkaqe sigurie, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre.

Për të garantuar se të gjithë votuesit me nevoja të veçanta mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ndërmerr këto aktivitete:

- përzgjedh qendrat e votimit të cilat janë të pajisura me pjerrina në hyrje të qendrës së votimit;
- ofron fletëvotimet në Brail për të iu mundësuar votuesve të verbër apo me të pamë të dobësuar të votojnë në mënyrë të pavarur;
- organizon ekipe mobile në të gjitha Komunat e Kosovës që të iu mundësoj votuesve me nevoja të veçanta që të ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit në ditën e zgjedhjeve nga vendi i tyre.

Votuesi i cili dëshiron të regjistrohet si votues **i ngujuar në shtëpi**, duhet të dorëzoj në Komisionin Komunal Zgjedhor (KKZ) deri më 19 tetor 2013, këto dokumente:

- 1 formularin e plotësuar, që mund të gjindet në zyret e KKZ-së ose në uebfaqen www.kqz-ks.org (butoni shërbimi i votuesve)
- 2 kopje të dokumentit të identifikimit (letënjoftim i vlefshëm, dokument i udhëtimit i vlefshëm, pasaportë e vlefshme);
- 3 një fotokopje të certifikatës së paaftësisë ose të diagnozës mjekësore në mbështetje të aplikimit të tij/saj.



Ju keni të drejtë të ankoheni tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) nëse iu mohohet e drejta për votim, nuk iu ofrohet qasje në qendra të votimit apo nëse vëreni parregullësi gjatë procesit zgjedhor.

PZAP është një institucion i pavarur që përbëhet nga 10 gjyqtarë, të cilët kanë përgjegjësi kryesore që të vendosin për ankesat zgjedhore. Ankesat duhet të ju përmbahen afateve kohore ligjore dhe duhet të kenë dëshmitë relevante kur të dorëzohen.

www.demokracianeveprim.org